



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/254

Datë: 19.04.2019

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2, pika d, nenit 17 pika b, nenit 40, të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 5 paragrafi 1.2 nën paragrafi 1.2.1 dhe nenet 10 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1, nenit 15 të Ligjit nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.30/23 gusht 2013), Udhëzimit Administrativ të MMPH nr.11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal, nenit 10, nenit 19 paragrafi 7 pika k, të Statutit të Komunës së Malishevës nr. 01/871 të datës 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e -IV- (katërt) të mbajtur me datën: 12.04.2019 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL TË KOMUNËS SË MALISHEVËS
2019-2027

Neni 1

Miratohet kërkesa nr.02/185 datë:22.03.2019 për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Malishevës për periudhën 2019-2027.

Neni 2

Plani i cekur si në pikën 1 të këtij vendimi përbehet nga pjesa tekstuale dhe grafike.

2.1. Pjesa tekstuale e planit përmban; profilin e zhvillimit hapësinorë dhe analizën e gjendjes, vizionin, parimet, caqet, kornizën e zhvillimit hapësinorë, strategjitë dhe planin e veprimt.

2.2. Pjesa grafike e planit përmban të dhëna hartografike dhe pjesë të tjera grafike, ku përshkruhet gjendja në hapësirë dhe ndërhyrjet në të.

2.3. Prezantimet hartografike të digjitalizuara të planit paraqesin tërësinë e zgjedhjeve të planifikuara.

Neni 3

3.1. Në pjesën tekstuale të planit paraqitet profili i gjendjes në Komunën e Malishevës, pozita rëndësia dhe çështje të tjera specifike të territorit të Komunës së Malishevës, konform me planin hapësinorë të Kosovës, analiza e profilit me të cilat tregohen përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të Komunës, si dhe mundësitë e ndikim socio-ekonomik dhe mjedisorë.

3.2. Përmbytja e vizionit dhe parimeve paraqet të ardhmen e Komunës së Malishevës, caqet dhe prioritetet strategjike zhvillimore afatgjate.

3.3. Korniza e zhvillimit hapësinorë komunal përmban strukturën dhe lokacionin hapësinorë për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm ekonomik, zonën ekonomike, çështjet sociale, vendbanimet, zonat e trashëgimisë kulturore, zonat e ndërtimit në zonat urbane dhe jashtë urbane.

3.4. Pjesa e zbatimit të planit përmban kushte të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në Komunë, destinimin e sipërfaqeve, zonave ndërtimore për vendbanime dhe strukturave ekzistuese jashtë zonave të vendbanimeve, dhe masat për parandalimin e ndikimeve negative në mjedis.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunës përmes Drejtorisë për Urbanizëm dhe organet tjera kompetente.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 të Rregullores nr.01/2017, për procedurën e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunës, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:
MAPL-së
Drejtoria Komonale
Arkivit të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit
Rrahim Morina

